



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

Numri: KSC-BC-2018-01

Vendosi: Paneli i përbërë prej një gjykatësi të vetëm
Gjykatës Nikola Giju

Administratore: Dr. Fidelma Donlon

Data: 24 shtator 2020

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publik

**Version i redaktuar publik i
urdhrit për transferim në objektin e paraburgimit të Dhomave të Specializuara**

Prokurorit të Specializuar

Xhek Smith

T'i dorëzohet

Z. Nasim Haradinaj

UNË, GJYKATËS NIKOLA GIJU, gjykatës i vetëm i Dhomave të Specializuara të Kosovës, i caktuar prej Kryetares së Dhomave të Specializuara në përputhje me nenin 33(2) të Ligjit nr. 05/L-53 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar (“Ligji”);

PASI KAM MARRË kërkesën rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte* të Zyrës së Prokurorit të Specializuar (“ZPS”) për lëshimin e fletarrestimeve dhe urdhrave të tjerë në lidhje me to, të datës 22 shtator 2020;

PASI KAM KONSTATUAR se ekziston dyshimi i bazuar që Nasim Haradinaj, zëvendëskryetari i Organizatës së Veteranëve të Luftës të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (“z. Haradinaj”) është penalisht përgjegjës për veprat penale të frikësimit gjatë procedurës penale, hakmarrjes dhe shkeljes së fshehtësisë së procedurës, të ndëshkueshme në bazë të neneve 387, 388 dhe 392 të Kodit nr. 06/L-074 – Kodi Penal i Kosovës i vitit 2019, sikurse përfshihen në nenin 15(2) të Ligjit;

PASI KAM KONSTATUAR se ekzistojnë arsye të artikulueshme për të besuar se arrestimi i z. Haradinaj është i domosdoshëm;

PASI KAM LËSHUAR fletarrestim për z. Haradinaj, i lindur më 21 maj 1963 në Gllogjan, Deçan, Kosovë, aktualisht shtetas i Kosovës, numri personal [REDAKTUAR], me adresë të fundit të ditur në [REDAKTUAR], Kosovë;

DUKE MARRË SHËNIM vendimin e Kryetares së Dhomave të Specializuara për caktimin e vendit të zhvillimit të kësaj procedure në Holandë (“shteti pritës”);

BAZUAR NË nenet 3(8)(a), 39(3), 41(5) dhe (7), 53 dhe 55 të Ligjit, rregullat 50, 55(4) dhe (6) të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës;

URDHËROJ Administratoren që këtë urdhër për transferim t’ia përcjellë Kosovës, cilitdo shteti të tretë përkatës (të tranzitit), nëse është rasti, dhe shtetit pritës;

URDHËROJ Administratoren të bëjë përgatitjet e nevojshme për transferimin e pa vonesë të z. Haradinaj në objektin e paraburgimit të Dhomave të Specializuara në shtetin pritës, në koordinim me ZPS-në dhe me autoritetet kompetente të Kosovës, të cilitdo shteti të tretë përkatës (të tranzitit), nëse është rasti, dhe të shtetit pritës;

URDHËROJ Administratoren që gjatë përcjelljes së këtij urdhri për transferim, të kërkojë ndihmë veçanërisht për: (i) kalimin e sigurt dhe të papenguar të z. Haradinaj dhe zyrtarëve shoqërues, si edhe të të gjitha gjësendeve të personave të lartpërmendur, nëpër kontrollet kufitare dhe pika të tjera kontrolli; (ii) pranimin e dokumenteve të udhëtimit dhe identifikimit të lëshuara nga shteti pritës ose Dhomat e Specializuara; dhe (iii) garantimin e sigurisë së çdo avioni dhe/ose mjeti tjetër transporti të përdorur për këtë transferim dhe mundësimin e kalimit të papenguar të ekuipazheve të tyre nëpër kontrollet kufitare shtetërore, në qoftë se është e nevojshme;

AUTORIZOJ Administratoren të urdhërojë autoritetet kompetente të Kosovës që t'i përcjellin Administratores çfarëdo të dhënash ose informacioni të rëndësishëm në lidhje me transferimin e z. Haradinaj, dhe rikujtoj se, duke pasur parasysh përparësinë e Dhomave të Specializuara kundrejt të gjitha gjykatave të tjera në Kosovë, autoritetet kosovare duhet të përmbushin këtë urdhër në përputhje me nenin 53(2) dhe (3) të Ligjit, duke mundësuar në këtë mënyrë zbatimin e transferimit të z. Haradinaj; dhe rikujtoj se, në rast se një subjekt, zyrtar i qeverisë së Kosovës, ose cilitdo person tjetër në Kosovë, pengon zbatimin e këtij urdhri ose shkel cilitdo prej kushteve të tij, kjo mund të përbëjë vepër penale në bazë të nenit 15(2) të Ligjit;

AUTORIZOJ Administratoren t'u kërkojë autoriteteve kompetente të cilitdo shteti të tretë (të tranzitit), nëse është rasti, që të ofrojnë ndihmën e tyre për zbatimin e transferimit të z. Haradinaj, në përputhje me nenin 55 të ligjit. Në lidhje me këtë, nëse do të paraqiten vështirësi teknike ose logjistike në ekzekutimin e këtij urdhri, autoritetet kompetente shtetërore ftohen t'ua bëjnë ato të ditura përfaqësuesve të ZPS-së dhe/ose Zyrës Administrative, sipas rastit;

URDHËROJ Administratoren të marrë të gjitha masat e nevojshme për garantimin e sigurisë operative dhe të sigurisë së z. Haradinaj dhe të cilitdo zyrtari të gjykatës dhe punonjësi tjetër që e shoqëron atë gjatë transferimit dhe deri në mbërritjen e tyre në vendin e paraburgimit në shtetin pritës dhe në shtetet e treta (të tranzitit);

VENDOS që ky urdhër, aktualisht i klasifikuar si rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*, mund t'u komunikohet ose ekzistenca e tij mund t'u bëhet e ditur autoriteteve kompetente të Kosovës, të një shteti të tretë (të tranzitit), dhe të shtetit pritës, në qoftë se është e domosdoshme për zbatimin e urdhrit të transferimit;

URDHËROJ ZPS-në t'i përcjellë Administratores të gjithë informacionin e disponueshëm që mund të ndihmojë në zbatimin e këtij urdhri për transferim si edhe çfarëdo informacioni tjetër të rëndësishëm për vlerësimin e ndonjë rreziku të mundshëm për viktimat dhe dëshmitarët që lidhet me arrestimin dhe transferimin e të dyshuarit; dhe

RIKUJTOJ se, në përputhje me nenet 53(2) dhe 54 të Ligjit, Dhomat e Specializuara kanë përparësi kundrejt të gjitha gjykatave në Kosovë dhe ky urdhër ka të njëjtën fuqi ligjore sikurse urdhrat e lëshuar nga cilado gjykatë apo cilido gjykatës tjetër i Kosovës.

/nënshkrim/

Gjykatës Nikola Giju
Gjykatës i vetëm

E enjte, 24 shtator 2020
Në Hagë, Holandë